

**Spirit Travel & Tours Sh.p.k**

**Pasqyrat financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

## Përmbajtja

RAPORTI AUDITUESIT TE PAVARUR.....	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE .....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	5
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE .....	6
1. Informacion i pergjithshem .....	7
2. Permbledhje e politikave kryesore kontabel.....	7
3. Politikat kontabel.....	8
4. Mjete monetare .....	11
5. Llogari te arketueshme tregtare .....	11
6. Te tjera llogari te arketueshme.....	12
7. Aktive afatgjata materiale .....	12
8. Qirate financiare dhe hua afatshkurtra.....	13
9. Llogari të pagueshme tregtare.....	13
10. Detyrime tatimore .....	14
11. Të tjera detyrime.....	14
12. Palet e lidhura .....	14
13. Totali i të ardhurave nga shfrytezimi, neto .....	15
14. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme .....	15
15. Shpenzime te tjera te shfrytezimit.....	16
16. Shpenzime financiare .....	16
17. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin .....	16
18. Angazhime dhe pasiguri .....	17
19. Ngjarje te mepashme.....	17

# **RAPORT AUDITIMI**

**Për Pasqyrat Financiare te shoqërisë**

**SPIRIT TRAVEL & TOURS ShPK**

**për periudhën nga**

**1 Janar deri 31 Dhjetor 2020**

## OPINIONI I AUDITUESIT TE PAVARUR

**Drejtuar:** Asamblesë Ortakeve  
Te Shoqërisë  
"SPIRIT TRAVEL & TOURS" SHPK

### **Raport mbi Pasqyrat Financiare**

#### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur te shoqërisë "SPIRIT TRAVEL & TOURS" SHPK te cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar te datës 31 Dhjetor 2020 dhe pasqyrën e te ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyrën e flukseve te parasë për vitin e përfunduar ne këtë date dhe një përmbledhje te politikave te rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare japin një pamje te vërtetë dhe te besueshme te pozicionit financiar te Shoqërisë "SPIRIT TRAVEL & TOURS" SHPK me date 31 Dhjetor 2020, si dhe te performances financiare dhe pasqyrës se flukseve te parasë për ushtrimin e mbyllur ne atë date, ne pajtim me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK).

#### **Baza për opinion**

Ne e kemi kryer auditimin tone ne përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Auditimit (SNA). Përgjegjësia jone sipas këtyre standardeve është përshkruar ne paragrafin Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare te shprehur ne këtë raport. Ne jemi te pavarur nga kompania qe auditojmë ne përputhje me Kodin e Etikes për Kontabilistet Profesioniste, se bashku me kërkesat etike relevante te auditimit te pasqyrave financiare ne Shqipëri, dhe ne kemi plotësuar edhe përgjegjësitë e tjera etike ne përputhje këto kërkesa dhe me Kodin e Etikes për Kontabilistet Profesioniste si me sipër.

Ne besojmë se evidenca e auditimit qe ne kemi marre është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për te dhënë opinionin tone te auditimit.

#### **Çështjet Kryesore te Auditimit**

Çështjet Kryesore te Auditimit janë ato çështje qe, nen gjykimin tone profesional, ishin me te rëndësishmet gjate auditimit te pasqyrave financiare te periudhës aktuale. Këto çështje janë adresuar ne kontekstin e auditimit te pasqyrave financiare ne tërësi, dhe gjate formimit te opinionit tone, për rrjedhoje, dhe ne nuk paraqesim një opinion te veçantë për këto çështje.

#### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe te Atyre te ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte te këtyre pasqyrave financiare ne përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK) dhe për ato kontrole te brendshme qe drejtimi i gjykon te nevojshme për te bere te mundur përgatitjen e pasqyrave financiare qe nuk përmbajnë anomali materiale qofte për shkak te mashtrimi apo gabimi.

Ne përgatitjen e Pasqyrave Financiare, Drejtimi është përgjegjës për matjen e aftësisë se vijueshmërisë se Kompanisë, duke paraqitur nëse është rasti, çështje te lidhura me vijueshmërinë dhe te përdorë parimin e vijueshmërisë vetëm ne qofte se ne te kundërt, Drejtimi ka për qellim te likuidoje kompaninë ose te ndërpresë veprimtarinë, ose nuk ka alternative realiste për te vazhduar.

Te ngarkuarit me Qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

### **Përgjegjësia e Audituesit**

Objektivat tone janë për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale qofte për shkak të mashtrimit apo gabimi, dhe lëshimi i raportit të auditimit që përmban opinionin tone. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është garanci që një auditim i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit do të zbulojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale në qofte se, individualisht ose në total, pritet që ato mund të kenë ndikim në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra duke u bazuar në këto pasqyra financiare.

### **Raport për kërkesat e tjera Ligjore dhe Rregullatorë**

Në angazhimin tone për auditimin e Pasqyrave Financiare të "SPIRIT TRAVEL & TOURS" SHPK nuk ka kërkesa të tjera nga ana e Drejtimit për tu raportuar nga ne.

Partneri angazhimit në auditim që rezultojnë në këtë raport auditues i pavarur është **Berti Pashko**

**HOLLY & ENDI AUDITING sh.p.k.,**



Tiranë, më 20 Maj 2021

Adresa: Blv. At Gjergj Fishta, Pall. E-88, Nr.12, KP.1001, tel./fax.2270905, e-mail: [hollyendiauditing@gmail.com](mailto:hollyendiauditing@gmail.com) Tirane

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR  
Më 31 Dhjetor 2020

	Shënime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	6,377,412	4,568,690
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	9,089,444	30,953,214
Llogari te arkëtueshme nga palet e lidhura	12	1,526,710	1,526,710
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	12,919,493	13,931,538
Parapagime dhe Shpenzime të shtyra	6	4,063,902	4,204,727
<b>Total Aktive Afatshkurtra</b>		<b>33,976,961</b>	<b>55,184,879</b>
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktive financiare			
Aktive afatgjata materiale	7	2,961,603	3,610,308
Aktive afatgjata jomateriale	7	202,263	269,691
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>3,163,866</b>	<b>3,879,999</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>37,140,827</b>	<b>59,064,878</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Qera Financiar dhe Hua afatshkurtra	8	-	562,182
Llogari të pagueshme tregtare	9	16,385,190	25,172,838
Te tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	3,037,467	6,523,700
Detyrime tatimore	10	58,032	376,889
Te ardhurat e shtyra		-	4,189,454
Të tjera detyrime	11	806,689	1,994,759
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>20,287,378</b>	<b>38,819,822</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata	8	-	-
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>20,287,378</b>	<b>38,819,822</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nënshkruar		16,466,935	16,466,935
Rezerva ligjore		156,467	156,467
Fitime te mbartura		1,387,185	1,387,185
Fitimi i ushtrimit	18	(1,157,138)	2,234,469
<b>Total kapitali themeltar</b>		<b>16,853,449</b>	<b>20,245,056</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>37,140,827</b>	<b>59,064,878</b>

Këto pasqyra financiare dhe shënimet shoqëruese nga 1 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, janë aprovuar me 30 Prill 2020 nga drejtimi dhe nëshkruar në emër të tij nga:

Dhimiter TOLA  
Administrator

**PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Shenime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	13	14,111,226	25,204,164
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	13	370,606	1,592,242
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>	14	<b>(9,678,199)</b>	<b>(11,285,534)</b>
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme			
2) Te tjera shpenzime		(9,678,199)	(11,285,534)
<b>Shpenzime te personelit</b>		<b>(4,964,061)</b>	<b>(11,207,395)</b>
1) Paga dhe shperblime		(4,258,188)	(9,671,995)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore (paraqitur			
2) vecmas nga shpenzimet per pension)		(705,873)	(1,535,400)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	(843,967)	(1,033,007)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	15	(135,955)	(357,464)
<b>Te ardhura te tjera</b>			
<b>Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve te mbajtura si</b>			
<b>aktive afatshkurtra</b>			
<b>Shpenzime financiare</b>	16	<b>(16,788)</b>	<b>(114,359)</b>
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur			
vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike			
1) brenda grupit)		(16,788)	(114,607)
2) Shpenzime te tjera financiare		-	248
<b>Pjese e fitimit/humbjes nga pjesmarrjet</b>			
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>(1,157,138)</b>	<b>2,798,647</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	18	<b>-</b>	<b>(564,178)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	(564,178)
2) Shpenzimi aktual i tatimit te shtyre			
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>	18	<b>(1,157,138)</b>	<b>2,234,469</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:</b>			
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>			
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>	18	<b>(1,157,138)</b>	<b>2,234,469</b>

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitim/Humbja e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>16,466,935</b>	<b>156,467</b>	<b>2,966,044</b>	<b>2,646,567</b>	<b>22,236,013</b>
Fitimi / Humbja e vitit				1,387,185	1,387,185
Transferim ne fitime te mbartura			2,646,567	(2,646,567)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>16,466,935</b>	<b>156,467</b>	<b>5,612,611</b>	<b>1,387,185</b>	<b>23,623,198</b>
Fitimi / Humbja e vitit			(5,612,611)	2,234,469	(3,378,142)
Transferim ne fitime te mbartura			1,387,185	(1,387,185)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2019</b>	<b>16,466,935</b>	<b>156,467</b>	<b>1,387,185</b>	<b>2,234,469</b>	<b>20,245,056</b>
Fitimi / Humbja e vitit				(1,157,138)	(1,157,138)
Transferim ne fitime te mbartura				(2,234,469)	(2,234,469)
<b>Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>16,466,935</b>	<b>156,467</b>	<b>1,387,185</b>	<b>(1,157,138)</b>	<b>16,853,449</b>

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE**  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Shenime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitim / Humbja e vitit	18	(1,157,138)	2,234,469
Shpenzimet financiare jomonetare			1,274,146
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	843,967	1,033,007
Rënie/(rritje) Llogari të arkëtueshme tregtare		21,863,770	(2,568,304)
Rënie/(rritje) Llogari te arkëtueshme nga palet e lidhura		-	100,620
Rënie/(rritje) Të tjera llogari të arkëtueshme		1,012,045	(866,047)
Rënie/(rritje) Parapagime dhe Shpenzime të shtyra		140,825	1,274,908
(Rënie)/rritje Llogari të pagueshme tregtare		<b>(8,787,648)</b>	5,454,925
(Rënie)/rritje Te tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura		<b>(3,486,233)</b>	(11,860,102)
(Rënie)/rritje Detyrime tatimore		<b>(318,857)</b>	(472,352)
(Rënie)/rritje Të tjera detyrime		<b>(1,188,070)</b>	1,192,107
(Rënie)/rritje në Te Ardhura te shtyra		<b>(4,189,454)</b>	
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>4,733,207</b>	<b>(3,202,623)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(127,834)	(55,833)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		<b>(127,834)</b>	<b>(55,833)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>			
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		(559,914)	(1,561,181)
Dividendë të paguar		(2,234,469)	(2,697,303)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		<b>(2,794,383)</b>	<b>(4,258,484)</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>		<b>1,808,722</b>	<b>(7,516,940)</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		4,568,690	12,085,630
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 Dhjetor</b>	<b>4</b>	<b>6,377,412</b>	<b>4,568,690</b>

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

**1. INFORMACION I PERGJITHSHEM**

Shoqëria Spirit Travel & Tours Sh.p.k. (me poshte referuar si "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit me datë 3 Dhjetor 2013 dhe pranë Degës së Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT L32403002P. Shoqëria zotërohet nga ortakët Nertila Kole dhe Dhimiter Tola me pjesëmarrje përkatesisht 50% secili ortak në kapitalin e Shoqërisë.

Me 31 Dhjetor 2020 vlera e kapitalit themeltar, është 16,466,935 Leke, e ndare në 100 kuota me vlerë nominale 164,669.35 Leke për kuota.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatese të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është: "Veprimtari turistike si agjensi udhëtimi, guide-përkthyes, tour operator, hoteliere, bar-bufë, restorant, transport udhëtarësh e taksë. Supervizim të fluturimeve, shërbimeve aeroportuale, shërbime call center. Ushtrim i veprimtarisë së agjentit të transferimit të parave në emer dhe për llogari të subjektit financiar jobanke. Shitjen e biletave të transportit ajror".

Administratori i Shoqërisë është Z. Dhimiter Tola  
Selia kryesore e Shoqërisë ndodhet në Sheshi Skenderbej, Pallati i Kulturës, kati 1re  
Numri i punonjësve të Shoqërisë me 31 Dhjetor 2020 është 9 (31 Dhjetor 2019: 13).

**2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL**

**2.1 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombetare të Kontabilitetit (SKK) të shpallura me datë 15 qershor 2006, të përmirësuara dhe të detyrueshme për zbatim për vitin financiar që fillon më 01 janar 2015, në përputhje me Ligjin 9228, datë 29 prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" të ndryshuar, me ligjin 9477, datë 9 shkurt 2006.

**2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, nëse ka të tilla.

**2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Keto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**2.4 Vleresime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabel të Shoqërisë dhe shumëve të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varesi të këtyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel janë të njohura në periudhën në të cilën vleresimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat me të rëndësishme të vleresimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabel të cilat kanë efektet me të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënime përkatese shpjeguese të pasqyrave financiare. Përdorimi i vleresimeve kontabel është minimal në keto pasqyra financiare.

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

**3. POLITIKAT KONTABEL**

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente gjate periudhes per te cilen jane pergatitur keto pasqyra financiare, perveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

**3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj**

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e asetëve dhe detyrimeve monetare me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 jane:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Leke/Euro	123.70	121.77
Leke/Dollare Amerikan	100.84	108.64
Leke/GBP	137.93	143.00
Leke/CHF	114.46	112.30

**3.2 Instrumenta financiare**

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare dhe llogari te pagueshme dhe qeraja financiare.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne shpenzime dhe te ardhura. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiar joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktiviteti financiar ose kur Shoqeria transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

*Paraja dhe ekuivalentet e parase*

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellime te pasqyres se fluksit te parase, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne llogarite rrjedhese dhe parane e gatshme ne arke.

*Llogari te arketueshme*

Llogarite e arketueshme (kerkesat e arketueshme) njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjoni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshitesite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

**3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)**

financiar, mospagesa ose pagesa të vonuara konsiderohen tregues që llogarite e arketueshme të zhvleresohen. Shuma e provigjontit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogari të pagueshme*

Llogarite të pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejte dhe me pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Qeraja financiare*

Qeraja financiare paraqitet me vlerën e tyre të drejte dhe me pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Te tjera*

Instrumenta të tjera joderivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

**3.3 Aktive afatgjata materiale**

*Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetegjatesi të ndryshme, ato kontabilizohen si zera të ndryshme (komponentet me të medhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*Kostot e mëposhme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zeri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabel të atij zeri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

*Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marrë për bazë jetën e dobishme të aktivit duke filluar nga dita kur ai është i gatshëm për përdorim. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Metodatat e amortizimit dhe përqindjet përkatëse sipas grupeve të aktiveve afatgjata për vitin aktual janë si më poshtë:

Mjete transporti	20% mbi vlerën kontabel neto
Pajisje informatike dhe software	25% mbi vlerën kontabel neto
Instalime elektrike	20% mbi vlerën kontabel neto
Mobilje dhe pajisje zyre	20% mbi vlerën kontabel neto

**3.4 Zhvleresimi**

*Aktivitet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase, të skontuara me normën efektive të interesit.

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

**3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.4 Zhvleresimi (vazhdim)**

Aktivet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivet e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut kreditor.

*Aktivet financiare*

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar te disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

*Aktivet jofinanciare*

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te Shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

**3.5 Provigjonet**

Nje provigjon njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

**3.6 Njohja e te ardhurave**

Te ardhurat jane flukset hyrese bruto te perfitimeve ekonomike lindur ne rrjedhen normale te aktiviteve te Shoqerise qe rezultojne ne rritje te kapitalit neto gjate periudhes dhe nuk perfshijne rritjet e kapitalit neto ne saje te kontributeve te ortakeve. Te ardhurat perfshijne vleren e drejte te shumes se arketuar apo te arketueshme nga shitja e mallrave dhe sherbimeve ne rrjedhen normale te aktiviteve te Shoqerise. Te ardhurat nuk perfshijne tatimin e vleres se shtuar, kthimet, rabatat dhe zbritjet, nese ka.

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne varesi te fazes se perfundimit te transakcionit ne daten e raportimit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

*Te ardhurat nga komisionet e shitjes se biletave te transportit nderkombetar*

Shoqeria siguron te ardhura nga sherbimet qe jep ne lidhje me shitjen e biletave te transportit nderkombetar nepermjet sistemit BSP te Shoqates nderkombetare te transportit ajror (IATA - International Air Transport Association). Gjithashtu te ardhura te tjera qe Shoqeria siguron nga sherbimet e kryera per te trete, etj. E ardhura perbehet nga cmimi i marre per sherbimin e kryer.

**3.7 Te ardhura dhe shpenzime financiare**

Te ardhurat financiare perfshijne fitimet nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe te ardhura te tjera nga interesat e llogarive rrjedhese apo depozitave. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit per qerane financiare, humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare.

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

**3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.8 Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020 është 15% (31 Dhjetor 2019 15%).

**4. MJETE MONETARE**

Mjetet monetare përfaqësojnë llogaritë rrjedhëse që Shoqëria ka me bankat në Shqipëri si dhe paraja në arke në valute dhe në monedhe vendase. Më poshtë po ju japim një detajim të llogarive me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019:

Pershkrimi i llogarive	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Para në bankë në monedhe të huaj	5,722,475	3,601,332
Para në bankë në monedhe vendase	405,304	86,550
Para në arke në monedhe të huaj	106,526	396,241
Para në arke në monedhe vendase	143,107	484,567
<b>Totali</b>	<b>6,377,412</b>	<b>4,568,690</b>

**5. LLOGARI TE ARKETUESHME TREGTARE**

Llogarite e arketueshme perbehen nga vlerat e drejtave ndaj klienteve te Shoqerise te cilet nuk kane shlyer ende detyrimin deri ne daten e ndertimit te pasqyrave financiare. Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 detajimet persa i perket klienteve me te medhenj paraqiten si me poshte:

Kliente	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Air Vallee SPA	4,413,454	4,344,594
Ericsson AB	-	3,266,125
Bucaj SHPK	-	2,923,727
Sabre Polska Sp z o.o	981,139	2,831,638
Kliente te ndryshem	1,462,438	11,056,015
NOVARTIS PHARMA SERVICES INC	16,557	2,365,030
Vodafone Albania sha	799,295	2,419,313
Philip Morris Albania shpk	278,436	551,300
AMARA TRAVEL	(42,183)	505,240
Klarita Sadiku	664,880	654,506
Trans Adriatic Pipeline AG	-	332,385
Mirela Fizi	79,951	450,573
Anita Luka	16	429,408
Lavdije Vucaj	459,028	368,784
Avni Kurti	(340)	338,482
Laim Manarkolli	(15,540)	320,023
Alda Vokshi	(39,627)	295,580
KALBAJ SHPK	330,071	261,307
BRITISH AMERICAN TOBACCO-ALBANIA	-	157,293
Armand Shahini	(1,667)	142,220
Lindita Ruka	88,061	221,364
Vladi Seferaj	24,357	121,558

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Albchrome Shpk	15,638	113,671
Besmira Marku	(13,948)	59,331
Alfons Lacaj	18,204	79,113
Ardian Ikonomi	(1,205)	10,557
Jon Impeks.	5,276	5,193
Olympus Travel	20,137	4,525
Real Xh.	(31,099)	(6,428)
intours albania	370	364
Marina Maze	601	592
Kliente te ndryshem per rimbursime	(3,233,178)	-
Eni Pejo	1,289,872	-
Tonela Kosta	767,400	-
Albion Musko	222,750	-
Kristina Koçollari	206,927	-
Friends Travel	-	(1,441)
<b>Total</b>	<b>9,089,444</b>	<b>30,953,215</b>

Kliente te ndryshem perbehen nga nje numer i madh klientesh te rastesishem por edhe nga kliente apo agjente te perhershem te cilet ne fund te periudhes kontabel kane vlera te vogla detyrimi.

**6. TE TJERA LLOGARI TE ARKETUESHME**

Te tjera te drejta te arketueshme me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

Të tjera llogari të arketueshme	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Deposita IATA	6,048,000	8,280,360
TVSH e arketueshme	6,335,884	5,221,637
Deposita AK Invest per dergesa	60,885	60,885
Debitor / Kreditor ASH AK-Invest	57,479	24,474
Tatim Fitimi I arketueshem	417,245	344,181
<b>Total</b>	<b>12,919,493</b>	<b>13,931,538</b>

Gjithashtu ne te tjera llogari te arketueshme jane perfshire dhe parapagimet dhe shpenzimet e shtyra te cilat me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

Parapagime dhe Shpenzime të shtyra	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Parapagime QuadLabs Platform	3,728,524	3,728,524
Parapagime per Furnitore	76,779	101,204
Paradhenie punonjes	258,600	375,000
<b>Total</b>	<b>4,063,902</b>	<b>4,204,727</b>

Hua / Qera financiare	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Qera financiare ASH	-	562,182
<b>Total</b>	<b>-</b>	<b>562,182</b>

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

**7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Aktivët afatgjata materiale me 31 Dhjetor 2020 perbehen si me poshte:

Kosto	Mjete	Pajisje	Instalime	Mobilje dhe	Software	Totali
	Transporti	informatike	Teknike	Zyre&Inventar I Imet		
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	9,497,212	1,282,656	442,952	490,446	767,121	12,480,387
Shtesa 2019	-	55,833	-	-	-	55,833
Pakesime 2019	-	-	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	9,497,212	1,338,489	442,952	490,446	767,121	12,536,220
Shtesa 2020	-	127,834	-	-	-	127,834
Pakesime 2020	-	-	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	9,497,212	1,466,323	442,952	490,446	767,121	12,664,055
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
Gjëndja më 31 Dhjetor 2018	(6,019,497)	(689,953)	(234,999)	(271,231)	(407,534)	(7,623,214)
Amortizimi i vitit 2019	(695,542)	(152,829)	(41,590)	(53,149)	(89,897)	(1,033,007)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	(6,715,039)	(842,782)	(276,589)	(324,380)	(497,431)	(8,656,221)
Amortizimi i vitit 2020	(556,428)	(148,699)	(33,276)	(38,136)	(67,428)	(843,967)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	(7,271,467)	(991,481)	(309,865)	(362,516)	(564,859)	(9,500,188)
<b>Vlera neto kontabël</b>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	3,477,715	592,703	207,953	219,215	359,587	4,857,173
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	2,782,173	495,707	166,363	166,066	269,690	3,879,999
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	2,225,745	474,842	133,087	127,930	202,262	3,163,866

**8. QIRATE FINANCIARE DHE HUA AFATSHKURTRA**

Llogaria Hua /Qira Financiare perfshin llogarite per qerate leasing. Qeraja financiare eshte marre per te financuar mjetet e transportit te Shoqerise (shenimi 7). Vlera totale e detyrimit te mbetur ne 31 Dhjetor 2019 prej 562,182 leke eshte likuiduar gjate vitit 2020 dhe ne 31 Dhjetor 2020 shoqeria nuk ka asnje detyrim per Qira Financiare

Qeraja financiare mbart nje norme interesi fikse prej 9% dhe nje detajim i tyre jepet si me poshte:

Hua / Qera financiare	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Qera financiare ASH	-	562,182
<b>Total</b>	<b>-</b>	<b>562,182</b>

**9. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE**

Te pagueshme ndaj furnitoreve perbehet nga vlera e paguar per sherbimet, mallrat, qerate, etj. por te paguara ende ne fund te periudhes. Llogari të pagueshme tregtare (furnitore) me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 perbehen si me poshte:



**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Te pagueshme	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
IATA Albania	3,306,333	6,527,016
Sabre Polska Sp z o.o	530,152	632,965
SABAH BAJRI	470,000	-
ESPRESSAMENTE VIAGGI E TURISMO S.r.l.	88,501	517,049
Planet SHPK	2,124,697	1,448,642
SKY HOTEL' S	760,228	830,460
Diplomat h.y shpk	-	668,907
Alpas 2E SHPK	-	216,100
Furnitore fatura te pamberritura	3,919,328	7,044,844
IFLY shpk	2,453,080	5,301,084
AIR ALBANIA	564,041	190,604
Olsi Shpk	139,547	185,323
Te tjere furnitore	554,731	545,614
Qtzhk Shpk	1,083,210	348,743
Duni Port Agency	-	194,984
Rogner Hotel	-	82,096
Nertil Koçibelli	328,000	180,000
Quadlabs Technologies Pvt Ltd	49,412	53,234
Blue Panorama Airlines Spa	(5,611)	(5,523)
Tivoli Gare Do Oriente	-	(10,464)
White City Hotel Sidnei shpk	19,541	221,160
<b>Total</b>	<b>16,385,189</b>	<b>25,172,838</b>

**10. DETYRIME TATIMORE**

Detyrimet ndaj organeve tatimore me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

Detyrime tatimore	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	58,032	256,539
Tatim mbi te ardhurat e personale	-	120,349
<b>Total</b>	<b>58,032</b>	<b>376,889</b>

**11. TË TJERA DETYRIME**

Te tjera detyrime me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

Të tjera detyrime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Paga e shperblime	435,643	352,568
Kreditore te tjere	371,046	1,642,191
<b>Total</b>	<b>806,689</b>	<b>1,994,759</b>

**12. PALET E LIDHURA**

Llogarite e arketueshme/pagueshme nga palet e lidhura perbehen nga vlerat e te drejtave/detyrimeve ndaj paleve te lidhura te cilet nuk jane shlyer/paguar ne daten e ndertimit te pasqyrave financiare. Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2020, transaksionet dhe te drejtat dhe detyrimet me palet e lidhura paraqiten si vijon:

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Llogari te pagueshme nga palet e lidhura	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Debitore / Kreditore IFLY	(1,380,670)	(2,552,264)
Debitore / Kreditore Ortak	(1,249,511)	(3,564,150)
<b>Total</b>	<b>(2,630,181)</b>	<b>(4,996,990)</b>

Te arketueshme / (Te pagueshme) palet e lidhura	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
IFLY (Furnitor)	(2,453,080)	(5,301,084)
Avioalb Services (Furnitor)	-	(149,215)
<b>Total</b>	<b>(2,453,080)</b>	<b>(5,450,299)</b>

Shitje / (Blerje) palet e lidhura	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
IFLY (Furnitor)	(2,309,059)	(20,385,940)
Albawings Klient	-	70,915
Albawings (Furnitor)	-	(118,131,252)
<b>Total</b>	<b>(2,309,059)</b>	<b>(138,446,276)</b>

**13. TOTALI I TË ARDHURAVE NGA SHFRYTEZIMI, NETO**

Shoqëria siguron te ardhura nga komisionet që merr për shërbimet që jep në lidhje me shitjen e biletave të transportit ndërkombëtar nepermjet sistemit BSP të Shoqatës ndërkombëtare të transportit ajror (IATA - International Air Transport Association). Gjithashtu te ardhura të tjera që Shoqëria siguron edhe nga ndërmjetësimi etj. E ardhura përbehet nga cmimi i marrë për shërbimin e kryer. Një detajim i te ardhurave neto të Shoqërisë jepet si më poshtë:

Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitim/(Humbje) nga kursi i kembimit	322,165	1,273,897
Te ardhura të tjera	48,441	318,345
<b>Total</b>	<b>370,606</b>	<b>1,592,242</b>

Një rakordim i te ardhurave nga qarkullimi me sistemin tatimor jepet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020
<b>Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne</b>	
Qarkullim i tatueshem	200,575,578
Vlera e biletave të shitura	(190,992,797)
Te ardhura nga fatura blerje	125,478
Te ardhura të tjera	39,665
Faturime të peridhave të tjera	4,436,134
Parapagime	(24,425)
Humbje nga kursi i kembimit	322,199
<b>Shuma e qarkullimit të korrektuar</b>	<b>14,481,832</b>
Sipas P.A.SH	14,481,832
<b>Diferenca</b>	<b>(0)</b>

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

**14. LENDA E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME**

Nje detajim i shpenzimeve te tjera dhe lendes se pare dhe materialeve te konsumueshme jepet si vijon per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019

Shpenzime te tjera	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shpenzime komisionerie biletarie	708,661	1,887,558
Shpenzime te tjera	1,917,953	1,813,034
Qira per zyra	4,389,638	4,298,414
Mirembajtje automjete	426,603	513,561
Transferime Udhetime Dieta	49,561	411,329
Shpenzime Interneti&Network	283,938	112,610
Taksa antaresimi	274,873	483,255
Shpenzime Karburanti	728,049	719,879
Shpenzime ligjore&auditimi	126,500	157,900
Sherbime komisione bankare	264,575	338,956
Shpenzime per taksa Tarifa vendore&Doganore	164,500	157,208
Shpenzime komunikimi&postare	338,640	232,046
Shpenzime kancelarie	4,708	124,834
Shpenzime marketingu	-	34,950
<b>Total</b>	<b>9,678,199</b>	<b>11,285,534</b>

Shpenzime per personelin	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Paga dhe shperblime	4,258,188	9,671,995
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore	705,873	1,535,400
<b>Total</b>	<b>4,964,061</b>	<b>11,207,395</b>

**15. SHPENZIME TE TJERA TE SHFRYTEZIMIT**

Shpenzime te tjera te shfrytezimit përfshijnë pagesat per gjoba te ndryshme te mara gjate ushtrimit te aktivitetit.

Gjoha dhe penalitete	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shpenzime per gjoba/Penalitete	135,955	357,464
<b>Total</b>	<b>135,955</b>	<b>357,464</b>

**16. SHPENZIME FINANCIARE**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit per Leasing

**17. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN**

Ne perputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme per tatimin mbi fitimin per periudhen 2020 eshte 15% (31 Dhjetor 2019 15%)

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit, por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimi jane vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shoqeria per vitin 2020 rezulton me humbje si per qellime kontabile ashtu dhe per qellime fiskale.

**SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Prej muajit Mars 2020, vendi u vendos ne lock down per shkak te pandemise COVID 19 dhe e gjithe situata ndikoi drejtperdrejt ne te ardhurat e shoqerise, duke qene se u pezulluan fluturimet ne mbare boten. Nje rikonsilim i tatim fitimit paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	<b>(1,157,138)</b>	<b>2,798,647</b>
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	<b>419,077</b>	<b>962,542</b>
Shpenzime te tjera	<b>419,077</b>	<b>962,542</b>
<i>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</i>	<b>(738,061)</b>	<b>3,761,189</b>
Fitimi para tatimit	<b>(738,061)</b>	<b>3,761,189</b>
<i>Tatim fitimi @15%</i>	<b>-</b>	<b>564,178</b>
Fitimi Neto	<b>(1,157,138)</b>	<b>2,234,469</b>

**18. ANGAZHIME DHE PASIGURI**

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Me 31 Dhjetor 2020, Shoqeria nuk ka çeshtje te cilat do te kene efekte negative ne pozicionin financiar te Shoqeria ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Gjithashtu, me 31 Dhjetor 2020, Shoqeria nuk ka angazhime kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

**19. NGJARJE TE MEPASSHME**

Shoqeria nuk ka ngjarje te ndodhura pas dates se mbylljes se Pasqyrave Financiare te cilat ndikojne ne rezultatin deri me 31.12.2020